



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË

Nr. 3036 / Prot.

Vlorë më, 24.12.2024

VENDIM  
Nr. 71, datë 23.12.2024

PËR  
MIRATIMIN E LISTËS SË STUDENTËVE QË PËRFITOJNË BURSË  
PËRJASHTIM DHE REDUKTIM NGA TARIFA

Mbështetur në nenin 49 të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", në VKM nr. 39, datë 23. 01. 2019 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 903, datë 21. 12. 2016 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore, për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë, të ndryshuar", VKM nr. 40, datë 23.01.2019 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 269, datë 29. 03. 2017 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit", i ndryshuar si dhe referuar propozimit të Administratorit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë ardhur me shkresën nr. 2956 prot, datë 17.12.2024, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 23.12.2024,

VENDOSI

1. Të miratojë dhënien e bursës për 39 (tridhjetë e nëntë) student, për vitin akademik 2023-2024, me efekt financiar 3,510,000 lekë.
2. Të miratojë përjashtimin nga tarifa për 44 (dyzët e katër) student, për vitin akademik 2023-2024, me efekt financiar 568,800 lekë.
3. Të miratojë reduktimin nga tarifa për 37 (tridhjetë e shtetë) studentë, për vitin akademik 2023-2024, me efekt financiar 1,249,800 lekë.
4. Ngarkohen për zbatim të këtij vendimi Administratori dhe Drejtorja e Shërbimeve Mbështetëse të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë.
5. Një kopje e këtij vendimi i përcillet Zv. Rektorit Akademik dhe Drejtorisë së Edukimit për Ciklin e Parë dhe të Dytë të studimeve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR  
Sotir NIKOLLA

Adresa / Adress: Bulevardi Vlore-Skele  
Tel. Fax ++355222288

Web-site: www.univlora.edu.al  
e-mail: info@univlora.edu.al

